



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	12.06.2025
REFERENC-Ë:	642-25-3096-2-1-1
PËR/ZA/TO:	Operatori Ekonomik: “MALSIIJA COMPANY” SH.P.K
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Zyra e Prokurimit - Kushtrim Mehaj – Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim për Aktivitetin e Prokurimit “Mirëmbajtja e rrugëve, punët në shenjëzim horizontal dhe vertikal” me nr.prok: 642-25-3096-2-1-1

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Mitrovicës Jugore në mbështetje të nenit 108/A, (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Operatori Ekonomik: “MALSIIJA COMPANY” SH.P.K, të datës 10.06.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e rrugëve, punët në shenjëzim horizontal dhe vertikal” me nr.prok: 642-25-3096-2-1-1, kundër NJOFTIMIT mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës standarde të datës 05.06.2025, Autoriteti Kontraktues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar me datë 03.06.2025, nga Operatori Ekonomik: “MALSIIJA COMPANY” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e rrugëve, punët në shenjëzim horizontal dhe vertikal” me nr.prok: 642-25-3096-2-1-1, kundër NJOFTIMIT mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës standarde të datës 05.06.2025.
2. Autoriteti Kontraktues qëndron prapa Njoftimit mbi vendimin për kontratë për Aktivitetin e Prokurimit dhe sipas LPP-ës dhe legjistacionit dytësor të Prokurimit Publik.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nëshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M M B I R E F U Z I M I N

Operatori Ekonomik: “MALSIIJA COMPANY” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e rrugëve, punët në shenjëzim horizontal dhe vertikal” me nr.prok: 642-25-3096-2-1-1, kundër NJOFTIMIT mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës standarde të datës 29.05.2025, ka bërë Kërkesës për Rishqyrtim me datë 10.06.2025 sipas nenit 108/A, të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L/237.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar për këto arsye:

PRETENDIMI ANKIMOR 1):

AK Komuna e Mitrovices ne FDT kerkon te Aneksi per paisje qe per secilin pozicion te paisjeve krahas dokumenteve per pasije te ofrohet edhe foto per ato paisje. GOE nuk ka ofrue foto te bashkangjitur me paisje, por dokumemntet e paisjeve i ngarkon ne nje fajll ndersa fotot ne tjetrin , me çka edhe vesh tire nderlidhen ato mes vedi. Poashtu mungojne disa foto per shabllone manual apo automatike per shigjeta . bus. Taxi. Etj.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 1 ANKIMORE NDAJ OE “MALSIIJA COMPANY” SH.P.K.:

Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me mungesën e fotove në ofertën e GOE të rekomanduar, nuk qëndron sepse në dokumentin e ofruar me emër: 9.1.2.5 ANEKSI 7 Lista e paisjeve, GOE të rekomanduar ka ofruar përshkrimin e secilës pasije të kërkuar në ANEKSI 7 e po ashtu I ka bashkangjitur edhe fotot e pajisjeve siq është kërkuar. Ju në këtë pretendim keni cekur pajisje të cilat nuk janë kërkuar me FDT e as në ANEKSI 7 siq është rasti “shabllone automatike apo manuale për BUS dhe TAXI !!! . Ne si AK kemi vendosur në ANEKSI 7 Listën e Pajisjeve për të cilat GOE I rekomanduar ka ofruar dëshmitë, por pajisjet që ju I keni cekur, nuk janë kërkesa të AK.

Ndërsa në të njëjtin dokument që kemi cituar më sipër, në faqën nr.35 GOE I rekomanduar ka ofruar Pajisjet për punimin me mas plastike të vendkalimeve , ishujve dhe shigjetave (shiko foton e cila është pjesë e ofertës së GOE së bashku me DUD Doganor):

Paisje për punimin me mas plastike të vendkalimev, ishujve dhe shigjetave



Këto pajisje janë konform kërkesë së Listës së pajisjeve me nr.rendor: 5 dhe 6 të ANEKSI 7 të dosjes së tenderit, e që GOE I ka ofruar së bashku me dëshmitë që janë kërkuar në FDT te kapaciteti Teknik dhe profesional.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 2):

GOE ka ofrue çmim jo-normalisht te ulte e qe ne Pajtim me rregullativen ligjore dhe udheziemve te miratuara nga KRPP shihet sheshit.

Bazuar ne kete rregullativ ne vijim po e paraqesim kete perlllogaritje te bazuar:

Jane 6 kompani konkurrese. GOE eshte per 259.1. euro nen 30 % e llogaritir te mesatares ($645.90/1.3 = 496.8$ euro) por edhe 60% nen kete mesatare. Kriteri dyte GOE eshte per 162.44 euro nen kriterin !0 % me ulte se oferta e dyte tenderuese mbi 40 % nen kete kriter te kesaj rregullative. Pra tre (3) kriteret e bejne GOE te papergjegjeshem ne ofere tn e tyre.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 2 ANKIMORE NDAJ OE “MALSIIJA COMPANY” SH.P.K.:

Sa i përket pretendimit tuaj nr.2 Lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta, ne kemi analizuar me kujdes ofertat e OE ofertues në këtë procedurë dhe kemi vërejtur se ka dallime të mëdha në çmime të OE ofertues dhe për të mos dëmtur buxhetin e AK-së, ne kemi vlerësuar se GOE i rekomanduar e që është i përgjegjshëm ka ofruar çmimin në përputhje me nenin 1 të LPP-së (Neni 1 Qëllimi) dhe Nenin 27 të rregullores për prokurim publik dhe Dosjes së tenderit e që është:

Neni 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës 27.1 Autoritetet kontraktuese mund të zgjedhin të bëjnë dhënien e kontratës në bazë të kriterit: a. Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë.

Po ashtu ju informojmë se sa i përket pretendimit tuaj (çmimeve jo normalisht të ulëta) edhe ju si GOE keni diferenca të cilat i keni cekur në ankesë. Sa i përket çmimeve ne kemi bërë analiza edhe të ofertës suaj. Pra nëse e krahasojmë ofertën tuaj me ofertën e renditur me çmimin më të lartë diferenca është e njëjtë dhe po ashtu plotësohen kushtet që ju i keni cekur për tu trajtuar si ofertë jo normalisht të ulët. Për të vepruar në përputhje me nenin 1 të LPP-së ne kemi përzgjedhur GOE që ishte i përgjegjshëm dhe ka çmimin më të ulët.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 3):

GOE ka ofruar disa Deklarata e Marrveshje për konzorcium dhe në fund të fajllit 6.4.1 dhe 11.1 nuk prezanton ANEKSIN 8 në përputhje me kërkesën e AK Komune e Mitrovices. Ankesi 8 faqja e parë obligative e dokumentit mungon dhe pikrisht aty rregullohen raportet mes palve të GOE që në këtë rast mungon dhe nuk janë përfshi fare palet e as që është përfshi numri prokurimit dhe titulli projektit, si dhe shkalla - përqaindja e pjesëmarrësve në konzorcium, që është Kërkese relevante , Kjo e bene GOE jo të përgjegjshëm dhe Komisioni vlersues është dashur ta eliminoi GOE nga procedura e metejme.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 3 ANKIMORE NDAJ OE “MALSIIJA COMPANY” SH.P.K.:

Sa i përket pretendimit nr.3 lidhur me Deklaratën e Grupit të Operatorëve Ekonomik, ju informojmë se GOE të rekomanduar, përveq që ka dorëzuar deklaratën e ANEKS 8 sipas dosjes së tenderit, po ashtu ka dorëzuar edhe Marrëveshjen e Grupit të Operatorëve Ekonomik dhe me këto deklarata ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit në pikën 11.1 të Dosjes:

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.
---	------	--

Dekleratat nën betim të GOE dhe Dekleratat e Grupit të OE janë në ofertën e GOE të rekomanduar në dokumentin e emëruar: 6.4.1 dhe 11.1.Deklarata dhe Marrveshjet.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

Gjithashtu ju njoftojmë se ju si GOE jeni i papërgjegjshëm pasi që në ofertën e juaj keni ngarkuar Sigurimin e Tenderin në mos përputhje me kushtet e përcaktuara sipas DT-së dhe NJK-së, pasi që ne kemi kërkuar 120 ditë validitet ndërsa ju keni prezentuar Sigurimin e Tenderit 90 ditë.

Si përfundim AK ju se pretendimet e paraqitura nga ana juaj nuk qendrojnë dhe janë të pabazuara në tërësi.

Bazuar në të dhënat e lartëcekura Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës,
i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe Legjislacionit sekondar të
LPP-së.